



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 578/1 Prot.

Tiranë, më 30/3/2017

Lënda : Për publikimin e listës së kandidatëve që kanë aplikuar për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Drejtuar: Zotit Igli TOTOZANI

AVOKATI I POPULLIT

TIRANË

I nderuar Zoti Totozani,

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u njoh me kërkesën tuaj, administruar me nr. 578 prot, datë 27.03.2017 dhe me rrethanat e parashtruara.

E drejta e privatësisë është një e drejtë themelore kushtetuese që gëzohet nga çdo njeri, qoftë edhe nga personat që kandidojnë për të ushtruar ose ushtrojnë funksione publike.

Është e rëndësishme që Avokati i Popullit, në cilësinë e kontrolluesit, në zbatimin e detyrimeve ligjore për kryerjen e këtij procesi vlerësimi, të respektojë të drejtat e subjekteve të të dhënave personale (kandidatëve), parimet e mbrojtjes së të dhënave personale sanksionuar në nenin 5 të Ligjit 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe të sigurojë që përpunimi i të dhënave të jetë i bazuar në dispozitat e tij.

Referuar kërkesës tuaj, konstatohet që emrat dhe mbiemrat e kandidatëve për pozicionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë bërë publike nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të dy listave.

Në bazë të Ligjit 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, këto janë elementët *par excellence* që bëjnë një person të identifikueshëm dhe për rrjedhojë konsiderohet e shteruar çështja e mbrojtjes së të dhënave personale.

Vlerësohet se publikimi i të dhënave personale legjitimohet sipas nenit 6/1/ç të Ligjit 9887/2008 në kuadër të veprimtarisë suaj sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Kriteret ligjore të papërbushura nga kandidatët që nuk janë kualifikuar, nuk përbëjnë të dhëna personale në kuptim të nenit 3/1 të Ligjit 9887/2008. Rrjedhimisht, vlerësojmë se publikimi i këtyre të dhënave nuk do të cënonte të drejtën e kandidatëve për mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit përkatës.

Sa i përket kopjes së raportit i cili është rezultat i punës verifikuese dhe vlerësuese të Avokatit të Popullit mbi përmbushjen e kriterëve formale të kualifikimit të kandidatëve, kërkuar nga Koalicioni i Shoqërisë Civile “Drejtësi për të gjithë”, Zyra e Komisionerit, duke marrë parasysh sa është parashtruar më sipër lidhur me të dhënat personale, interesin publik që paraqet procesi i reformës në drejtësi dhe aktivitetin e Avokatit të Popullit në këtë proces (aktiviteti i cili kufizohet në vlerësimin e kriterëve ligjorë të listuar nga Ligji 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”), parimin e balancës midis të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale, vlerëson se ky raport përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të Ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe si i tillë duhet të publikohet.

Pavarësisht sa më sipër, nëse konsideroni që ky raport përmban të dhëna, publikimi i të cilave do të cënonte sferën e privatësisë së kandidatëve, ai mund të vihet në dispozicion të kërkuarit duke hequr pjesët që kufizohen në përputhje me nenin 17, pika 6 e Ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj.

Me respekt,

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
